

HYRJE

Raporti Fillestar i tanishëm propozon hollësi për implementimin e projektit *Projekti i Shfrytëzimit të Tokës Bujqësore, EuropeAid/120769/D/SER/KOS*, i financuar nga BE, përmes Agjencionit të tij Evropian për Rindërtim (EAR). Përshkrimet e Punëve (ToR) e cilësojnë qëllimin e projektit, sa i përket shtimit të produktivitetit dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore. Projekti synon ta arrij këtë duke i përcaktuar 5 komponentet e projektit ("rezultatet"), të cilat përkatësisht kanë të bëjnë me (i) kornizën ligjore dhe rregullative, (ii) komasacionin (konsolidimin) e tokës, (iii) planifikimin hapësinor dhe mjedisit, (iv) qasjen në tokë, përmes trustit të tokës dhe (v) mekanizmat përmirësues të koordinimit.

Projektit i është ndihma teknike e konsorciumit, të përbër nga:

- *GFA Consulting Group, Germany*, firmë udhëheqëse shumëdisiplinare gjermane. GFA është partner kryesor.
- *The Directorate for Food, Fisheries and Agri Business (DFFE), nën Ministrinë e Ushqimit, Bujqësisë dhe Peshkimit, Denmark*. DFFE është agjensioni kryesor i komasacionit të tokës dhe hipotekës së tokës në Danimarkë.
- *Bodenverwaltungs – und – verwaltungs GmbH (BVVG), Gjermani*. BVVG-ja është agjension shtetëror, përgjegjës për administrimin dhe privatizimin e tokës bujqësore dhe pyjore të pronës shtetërore në Gjermani.

Data e mobilizimit të ekipit të projektit ishte 13 Shkurti 2006. Periudha fillestare ka filluar në datën e njejtë të mbledhjes fillestare të EAR-it dhe ka zgjatur gjerë më 03 Prill 2006. Në atë periudhë të shkurtër, është formuar një ekip fillestar për të përgatitur raportin fillestar, që përbëhej nga dy ekspertë afatgjatë ndërkombëtar dhe dy ekspert afatshkurtër ndërkombëtar (secili nga dy javë). Ai është ndihmuar nga drejtoresha e projektit të GFA-së dhe një javë nga stafi i zyrës së Zyres Qëndrore të GFA-së.

Ky Raport Fillestar e ndjek të njejtën vijë mendimi si propozimi i GFA-së, por ai është detajizuar dhe përshtatur në pajtim me informatat e marra gjatë periudhës fillestare. Janë mbajtur shumë mbledhje dhe diskutime në Prishtinë dhe komuna të ndryshme. Janë bërë vizita dhe mbledhje bashkë me zyrtarët e palëve shoqëruese të projektit dhe së bashku janë gjetur zgjidhjet dhe marrë vendimet. Ekipi fillestar ka marrë informata, vizione, rekomandime, sugjerime dhe mundësi të shumta. Kjo informatë është shfrytëzuar me dëshirë, për të përgatitur programin e projektit, i cili është ambicioz dhe në të njejtën kohë real.

Mendojmë se në këtë Raport Fillestar, janë përmbushur mirë kërkesat e ToR-it dhe propozimi i projektit. Është bërë përjashtim në vendosjen e Rezultatit 4, të trustit të tokës. Duket se idetë fillestare, të formuluar në ToR nuk ishin të realizueshme, dhe pas



diskutimeve me MBPZHR-në dhe AKM-në është vendosur që sa më shumë të jetë e mundur të shqyrtohen mundësitë tjera, për të përmbushur qëllimet e Rezultatit 4,.

Përmbajtja e raportit është si vijon. Kaptina 3 jep një azhurnim të historikut të projektit. Kaptina 4 i shtjellon disa supozime dhe rreziqe. Kaptina 5 i përpunon aktivitetet e projektit dhe paraqet planin e tërësishëm të punëve dhe zgjërohet në aktivitetet, gjatë tremujorit të ardhshëm. Kaptina 6 jep hollësi të implementimit të përgatitjeve, përfshirë programin trajnues.

Ngrohtësisht i falenderojmë të gjithë ata persona, të cilët në mënyrë të hapur i ndan pikëpamjet, idetë dhe përvojat me ne, për fillim të suksesshëm të implementimit të projektit.